REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA, INTEGRIMIT EVROPIAN, PERFORMANCËS DHE DIXHITALIZIMIT TË TË DHËNAVE

Nr.1530 Prot

Përmet, më 13 . 05 .2025

Lënda: Njoftim për rekrutim stafi në kuadër të zbatimit të projektit "Përqafimi i shpresës, një oaz për ata që kanë nevojë"

ZYRËS VENDORE PËR PUNËSIM DHE AFTËSI PËRMET

NJOFTIM

PËR REKRUTIMIN E STAFIT KOORDINATOR PROJEKTI NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT "PËRQAFIMI I SHPRESËS, NJË OAZ PËR ATA QË KANË NEVOJË"

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", VKB Nr.107 datë 18.12.2024 "Për buxhetin e Bashkisë Përmet për vitin 2025"; VKB Nr.79 datë 23.10.2024 "Për miratimin e Planit Social 2024-2027 për Bashkinë Përmet, Marrëveshjen Nr.72 Prot datë 13.01.2024, midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë Përmet, në zbatim të projektit «Përqafimi i shpresës , një oaz për ata që kanë nevojë», Shkresës nga Shërbimi Social Shtetëror Nr. 697 Prot datë 10.03.2025, Bashkia Përmet kërkon të rekrutojë staf për zbatimin e projektit si më poshtë:

Nr.	Pozicioni	Angazhimi
1	Koordinator	1 (31 muaj)

I. Personat e interesuar, duhet të paraqesin pranë autoritetit kontraktues dokumentacionin e kërkuar si dhe të plotësojnë kriteret si mëposhtë:

1. **Kriteret që duhet të plotësojë Koordinatori janë:**
   a) Të jetë shtetas shqiptar;
   b) Të ketë arsim të mesëm;
   c) Të ketë eksperiencë pune;

Përshkrimi i punës:

1. Koordinatori duhet të ndjekë të gjithë menaxhimin, mbarëvajtjen e punës si dhe koordinimin me strukturën e Shërbimit social në Bashkinë Përmet duke referuar dhe raportuar cdo situatë gjatë zbatimit të projektit për një periudhë 31 muaj.
2. Koordinatori do të kujdeset për mbarëvajtjen e aktiviteteve të Qendrës Ditore për të moshuarit, organizimin e aktiviteteve sipas planit të aktiviteteve të projektit.

3. Dokumenton zbatimin e aktiviteteve në kohë dhe i raporton Drejtorisë së Shërbimit Social në Bashki.
4. Harton dhe dorëzon në drejtori gjithë procesin e punës së kryer nga ana e tij në lidhje me këtë pozicion.

Ky pozicion do të trajtohet me pagë neto 43 000 lekë/muaj.

Dokumentacioni kërkuar:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1- Jetëshkrimi i aplikantit CV;
2- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
3- Certifikatë familjare;
4- Diplomë e arsimit të mesëm e noterizuar;
5- Vërtetim si punëkërkues i papunë;
6- Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore;
7- Vërtetim Gjykate;
8- Vërtetim Prokurorie;
9- Librezë pune;
10- Librezë mjekësore;
11- Certifikime, kualifikime nëse disponohet;

Personat e interesuar mund të kërkojnë informacion për proçedurën konkurruese, pranë Bashkisë Përmet.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit në Bashkinë Përmet, brenda datës 20.05.2025.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA PËRMET